



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS

KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

Tel/Fax: +381 38 227 782; Mob: +377 44 622 000; info@noc-kosovo.org; www.noc-kosovo.org
Adresa: Rr. Agim Ramadani nr. 43, Shtëpia e Sporteve, kati I, nr. 10, 10000 Prishtinë, Kosovë

EKSTRAKT

Nga Mbledhja e 19 e BE te KOK, e mbajtur me 22 Prill 2014

Prezent: Besim Hasani, Shasivar Haxhijaj, Fatmir Makolli, Artan Rugova, Arben Lila, Fadil Vokrri, Shqipe Zogiani, Ismail Kosumi, Nezir Rama.

Munguan: Vjollca Krasniqi e Ramadan Selimi(me arsye) dhe B. Gerbic (pa arsye)

Te pranishmit unanimisht miratuan Rendin e Dites ne vijim:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga Mbledhja e 18 e BE te KOK, e datës. 25.03.14**
- 2. Aktivitetet midis dy mbledhjeve te BE te KOK**
 - a) Nënshkrimi i Protokollit MKRS-KOK
 - b) Informate nga pjesemarrja e presidentit te KOK ne Konventen e 16 te Sportaccord-it e mbajtur ne Belek te Turqise nga 6-11 Prill 2014
 - c) Informate nga pjesemarrja e Presidentit të KOK në Kampionatin Boteror të Boksit për të rinj në Sofje të Bullgarise ku merrte pjese Kosova me 5 perfaqesues.
 - d) Informate nga Kampionati Boteror ne karate-Shotokan, i organizuar ne Prishtine prej 6-8 Prill 2014
- 3. Caktimi i kryetareve të Komisioneve**
- 4. Te ndryshme:**
 - a) Letra e FXHK drejtuar KOK lidhur me Bursa Olimpik nga Solidariteti Olimpik
 - b) Paralajmerimi i vizites ne KOK nga Stavri Bello, sekretari Gjeneral i KOKSH.
 - c) Ardhja në vizite e perfaqesuesve të Revistes me prestigjioze sportive “InsidetheGames” nga Britania e Madhe
 - d) Shqyrtimi i kërkesës së Aferdita Fazliut, kryetare e Komisionit “Femra dhe Sporti” që në Forumin e IWG në Helsinki të merrë pjesë edhe Sanije Krasniqi

- e) Shqyrtimi i kërkeses së Aziz Salihut për bashkeorganizim dhe ndihme financiare për festimin e 30 vjetorit të fitimit të Medaljes së bronzte Olimpikë.
- f) Angazhimi i sekretarit teknik nga 1 Maji 2014
- g) Evidentimi i të interesuarve për "Final four" dhe për vrapim në Gjysemmaratonen e Prishtinës.

PIKA 1

Ekstrakti nga Mbledhja e 18 e BE të KOK e mbajtur me 25.03.2014 u miratua pa vërejtje.

Pika 2.

- a) Presidenti Hasani informoj për nënshkrimin e Memorandumit MKRS-KOK me të cilin MKRS ndane për KOK 50.000 euro për lehtësimin e zbatimit të Planit të Punës së KOK. U konstatua se ky është një fillim i mbare për pavaresimin financiar të KOK përkunder që nevojat e KOK janë shumë më të larta por që është e domosdoshme që Komisioni i Marketingut të gjejë sponzor për KOK.
- b) Presidenti i KOK informoj lidhur me pjesëmarrjen e tij në Konventen e Sportaccord-it e mbajtur në Belek prej 6-10 Prill 2014 dhe për takimet e shumta me president të shumtë të Federatave Nderkombetare dhe anetare të BE të KON, e ku u vecua takimi me Presidentin e KON-it z. Thomas Bach dhe Presidentin e Sportaccordit z. Marius Vizer
- c) Presidenti Hasani me datën 15 Prill 2014, së bashku me përfaqësuesit e FBxK, udhetoj për Sofje ku mbahej Kampionati Botëror për të Rinj i organizuar nga AIBA e ku morrte pjesë edhe kombëtarja e Kosovës me 5 bokser. Përveç inkurajimit të bokseve për të dhënë me të mirën prej tyre, Presidenti Hasani dhe Sekretari i përgjithshëm i FBxK z. Mehmet Bogujevcin takuan z. Ho KIM, drejtor i AIBA-s i cili inkurajoj FBxK të aplikoj për kurse për ngritjen e kapaciteteve të trajnereve të rinj që kanë njohuri edhe të gjuhës angleze dhe të aplikojnë në AIBA për praninë me të drejta të plota në Kongresin e AIBA-s që do të mbahet në Kore të Jugut në Nentor të vitit 2014. Nga ana tjetër, delegacioni ynë falenderoj z. Ho KIM dhe z. Ching Kuo WU për mbështetjen që po i japin FBxK sidomos për ftesat në kampe për stërvitje për bokseser të Kosovës dhe për RINGUN olimpik. z. Ho KIM u ftua të vizitoj Kosovën me 23 Maj 2014 kur FBxK organizon Turneun ndërkombëtar Lah Nimani. Takimi tjetër me rëndësi ishte me Kryetarin e Federatës së Boksit i cili ishte edhe nënpresident i KO të Bullgarisë. Ai premtoj mbështetje të nduarnduarshme për FBxK dhe për KOK
- d) Shqipe Zogiani dhe Nezir Rama folën për Kampionatin Botëror të Karatese në Shotokan të organizuar në Prishtinë prej 4-6 Prill 2014 ku kishin marrë pjesë 54 shtete me mbi 1400 karateiste të grupmoshave të shumta. Anëtarët e BE të KOK u familjarizuan me statsin e WSKU por megjithatë, përgezuan FKK për këtë organizim dhe Nezir Ramen për medaljen e bronzte në disiplinën Kata për veterane.

PIKA 3

Presidenti Hasani, pas konsultimit me anëtarët e BE të KOK, i emeroj ata të udhëheqin Komisionet në vijim, dhe i autorizoj të njejtët që të zgjedhin anëtarët tjerë të Komisionit deri në mbledhjen e ardhshme

e cila planifikohet te mbahet me 29 Prill 2014. Kryetaret tjere te Komisioneve, Presidenti Hasani, do ti propozoj ne mbledhjen e rradhes.

Komisioni per Marredhenie me jashte: **Besim Hasani**

Komisioni per akte juridike: **Shasivar Haxhijaj**

Komisioni Sporti Elitar: **Fatmir Makolli**

Komisioni per marketing: **Arben Lila**

Komisioni Sporti dhe Media: **Artan Rugova**

Komisioni Sporti dhe Ambienti: **Shqipe Zogiani**

Komisioni Sporti ushtarak: **Ismail Kosumi**

Komisioni Mjekesia sportive: **Nezir Rama**

Komisioni Sporti dhe Femra: **Aferdita Fazlija**

Komisioni Sporti Universitar: **Sadik Krasniqi**

Komisioni Sporti Policor: **Anton Cena**

Komisioni Dita e Sportit: **Ismet Rexhepi**

PIKA 4

- a) Lidhur me letren e Federates se Xhudos se Kosoves drejtuar KOK per aplikim ne KON per Bursa olimpike, BE i KOK vendosi qe, me shkrim, ti drejtohet te gjitha Federatave Olimpike te Sporteve individuale te Kosoves qe te dergojne nga dy sportiste, per te cilet mendojne se meritojne Bursen Olimpike qe ndahen nga Fondi i Solidaritetit Olimpik te KON.
- b) Stavri Bello do te vizitoj KOK me daten 27 Prill 2014. BE i KOK shprehu gatishmerine qe ti beje nje pritje dhe me te se bashku te percjellim edhe FinalFour qe mbahet ne Prishtine, me 27 Prill 2014.
- c) KOK-un do ta vizitojne dy perfaqesues te revistes prestigjioze Insidethegames. BE i KOK vendosi qe te mbuloj shpenzimet e buletave te aeroplanit, akomodimin dhe ushqimin gjate qendrimit te tyre me 20 e 21 Maj 2014.

d) Kërkesa e Aferdiat Fazliut, Kryetare e Komisionit Sporti dhe Femra, qe pervec saj dhe Shqipe Zogianit, te bashkangjitet edhe Sanije Krasniqi, anetare e ketij Komisioni, per pjesemarrje ne Forumin e IWG qe mbahet ne Helsinki, u miratua njezeri. Per kete udhetim nga KOK ndahen 3.000 euro.

e) Aziz Salihu ka derguar nje kerkese ne KOK qe te organizohet nje spektakel me rastin e 30 vjetorit te fitimit te medaljes se bronzte ne Olimpiaden e Los Angjelosit dhe me rastin e 60 vjetorit te lindjes se tij. BE i KOK kishte dy verejtje serioze ne kerkese, sepse ajo i ishte drejtuar PTK dhe ne te ishte shenuar se organizatore te saj eshte Komiteti Olimpik i Kosoves dhe Shqata e Pavarur e ...Pas diskutimeve te shumta u vendos qe te ftohet Aziz Salihu dhe te njoftohet se BE i KOK ka gatishmeri te ftoje Aziz Salihun ne zyret e KOK dhe ti ndaj nje Mirenjohje me rastin e 60 vjetorit te lindjes dhe 30 vjetorin e medaljes se bronzte olimpike. Perndryshe BE i KOK eshte i gatshem qe mirenjohjen t'ia dorezoje Aziz Salihut ne spektaklin eventual qe ai do ta organizonte! KOK nuk eshte organizatore e as bashke organizatore e spektaklit qe eventualisht do te organizoj Aziz Salihu apo ndonje organizate tjeter!

f) BE i KOK vendosi qe te shpall Konkurs per pranimin e nje sekretari teknik i cili do te angazhohej te punoj ne KOK nga 1 maji i vitit 2014. Komisioni ne perberje: Besim Hasani, Shasivar Haxhijaj, Nezir Rama, Fatmir Makolli dhe Ismail Kosumi do te caktojne kushtet qe do te kerkohen me konkurs i cili do te shpallet ne webfaqen e KOK dhe ne gazeten e perditshme SPORTI.

g) Anetaret e BE te KOK pergezojne Klubin e Basketbollit "Prishtina" per marrjen e organizimit te Final Four te Ballkan Liges dhe shumica prej tyre shprehen gatishmerine te jene prezent ne gjysemfinale dhe finale andaj u autorizua Presidenti te kerkoj nga KB Prishtina te sigurohen buleta per BE te KOK dhe per Sekretarin e pergjithshem te KOKSH z. Stavri Bello, mundesisht ne uleset VIP. BE i KOK ne shenje mbeshtetje ndaj Gjysemmaratones se Prishtines vendosi qe te gjithe te nisen dhe te vrapojne ne Gjysemmaratone.

Mbledhja perfundoj ne 13,30

Ekstrakti u perpilua nga Besim Hasai, bazuar ne Procesverbalin e mbajtur nga Jeton Rudari.